



## Informata lidhur me provimet e Institutit Gëte

### Paraqitja e provimit

- 1. Rregullorja e provimit** gjendet në zyrën e provimeve dhe në ueb-faqen e Institutit Gëte Shkup, <https://www.goethe.de/pro/relaunch/prf/de/Pruefungsordnung.pdf>
- 2.** Rekomandohet, që para paraqitjes të **informoheni** rreth këtij provimi. Në ueb-faqen e Institutit Gëte ([www.goethe.de](http://www.goethe.de)) e gjeni vegëzën „Unsere Prüfungen“ (Provimet tona). Aty do të gjeni te provimet veç e veç informata lidhur me parakushtet, pjesët e provimeve si dhe materiale informimi dhe ushtrime, përfshirë edhe një mostër të provimit. Vetëm pasi të keni pasur pak vështirësi gjatë plotësimit të kësaj mostre, atëherë do të duhej të paraqiteni për provim.
- 3. Para paraqitjes së provimit dhe pagesës** ejani Ju lutemi në zyrën e provimeve të Institutit Gëte Shkup në Qendrën Gëte Prishtinë. Këtu i gjeni të gjitha informatat dhe dokumentet për paraqitjen e mëtejme.

Gëte Qendra Prishtinë  
Mujo Ulqinaku 7 / 10000 Prishtinë

☎ +381 38 224909 ose +377 45 322052  
✉ [pruefungen@slzprishtina.org](mailto:pruefungen@slzprishtina.org)

- 4.** Paraqitjen në zyrën e provimeve mund ta bëni vetëm **personalisht**. Me këtë rast duhet të dorëzohen:
  - **Pasaporta** e Juaj valide
  - **Pagesa bankare** e tarifës së provimit
- 5.** Terminet e provimeve jepen sipas radhës së paraqitjes së tyre.
- 6.** Për terminin e provimit me **shkrim** dhe me **gojë** duhet të sjellni me veti:
  - **Pasaportën** e Juaj valide
  - **Formularin** e Juaj të **paraqitjes**
  - **Pagesën** e Juaj **bankare**

Mungesa e ndonjërit prej këtyre dokumenteve e pamundëson pjesëmarrjen në provim.

- 7.** Prej provimit **përrjashtohet** kushdo që mashtron, sjell mjete ndihmëse të ndaluara, i përdor apo u jep të tjerëve ato, ose përmes sjelljes së vet pengon mbarëvajtjen e provimit. Në këtë rast rezultatet e arritura në provim nuk vlerësohen. Si mjete ndihmëse të ndaluara konsiderohen materialet konkrete, të cilat as nuk përkojnë me materialet e provimit e as nuk janë paraparë me dispozitat e mbajtjes së provimit. Nuk lejohet të mirren me veti as në hapësirën përgatitore, e as në hapësirën e provimit pajisjet ndihmëse teknike, si: telefona mobil, mini kompjuterë apo pajisje tjera për regjistrim apo emitim. Nëse një pjesëmarrës/e përrjashtohet nga provimi për ndonjërin shkak të cekur në këtë paragraf, provimi mund të përsëritet vetëm pas **gjashtë muajve** nga dita e përrjashtimit nga provimi.

[www.goethe.de](http://www.goethe.de)

**GOETHE  
INSTITUT**


Sprache. Kultur. Deutschland.



8. Nëse ndonjë pjesëmarrës/e **mashtron** apo tenton të mashtrojë në provim lidhur me **identitetin** e tij/saj, provimi mund të përsëritet më së paku pas **dymbëdhjetë muajve** nga dita e përjashtimit nga provimi.
9. Pas provimit lidhur me rezultatin do të informoheni në internet sipas numrit të Juaj të provimit. Ky rezultat publikohet edhe në zyrën e paraqitjes së provimit.
10. Nëse provimi kalohet me sukses, **certifikata** e Juaj do të lëshohet nga Instituti Gëte Shkup dhe dorëzohet më së paku pas një muaji pas terminit të provimit duke u paraqitur me pasaportë në zyrën e paraqitjes së provimeve të Qendrës Gëte Prishtinë.
11. **Dokumentacioni i provimit** do të administrohet sipas dispozitave të rregullores në fuqi të Institutit Gëte Shkup.
12. Një **përsëritje** e provimit është e mundur më së paku pas një muaji pas ditës së rënjes nga provimi.

Gëte Qendra Prishtinë  
Mujo Ulqinaku 7 / 10000 Prishtinë

☎ +381 38 224909 ose +377 45 322052  
✉ [pruefungen@slzprishtina.org](mailto:pruefungen@slzprishtina.org)



[www.goethe.de](http://www.goethe.de)

Kati Stiebich  
E ngarkuara për provime Kosovë  
Gëte Institut Shkup  
✉: [kati.stiebich@goethe.de](mailto:kati.stiebich@goethe.de)  
<http://www.goethe.de/skopje>

**GOETHE  
INSTITUT**

Sprache. Kultur. Deutschland.